



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 266₅ prot.

Tiranë, 26.7.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik Darjel Sina kundër vendimit nr.24, datë 13.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Bashkim Dedja.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 i Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese.
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 13.07.2018 është njoftuar vendimi nr.24 datë 13.06.2018 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin në rivlerësim z. Bashkim Dedja, kryetar i Gjykatës Kushtetuese.

Bazuar në gërmën “c” të pikës 3 të nenit B të Aneksit të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 65 të ligjit 84/2016, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, me shkresën nr.1003/1 datë 13.07.2018, ka paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, rekomandimin për të paraqitur ankim kundër vendimit nr. 24 datë 13.06.2018 për rastin e subjektit të rivlerësimit z.Dedja. Rekomandimi është dhënë dhe firmosur sipas përcaktimeve ligjore nga një komision i përbërë nga tre vëzhgues ndërkombëtarë, përfaqësues të Operacioni Ndërkombëtar të Monitorimit¹.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C pika 2, Neni F pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63 pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

¹ Konkretisht

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15 ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj Vendimit nr.24 datë 13.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Proçesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit z. Bashkim Dedja është gjyqtar që nga viti 1993 dhe aktualisht ushtron detyrën e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016 i është nënshtruar proçesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë.

2. Mbështetur në pikën 1 të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës proçesi i rivlerësimit për subjektin z.Bashkim Dedja, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tre kriterëve atë të pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*), dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë (*në vijim referuar si Inspektoriati*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33 pika 5 e ligjit nr.84/2016, me anë të “*Aktit përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Bashkim Dedja¹*”, ka referuar për subjektin se:

- i. *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr.84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin², ka referuar “*Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës*” raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit nga publiku.

2.3 Inspektoriati, bazuar në pikën 2 të nenit 39 të ligjit 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit³ raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku, nga ana e Komisionit nuk janë gjetur elementë që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që çenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

¹ Protokolluar pranë Komisionit me nr.339 prot. datë 06.11.2017.

² Referohu shkresës nr.11 prot KPK datë, 06.11.2017

³ Shkresa nr.***** prot datë 01.12.2017

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka realizuar një proces kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

3.2 Nga hetimi administrativ mbi 4 (katër) pasuri të paluajtshme (3 në pronësi të subjektit dhe një të *****), Komisioni ka konstatuar se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. Ka qenë i saktë dhe i vërtetë në deklarin e tij.

4. **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr.84/2016, Komisioni pas administrimit të raportit të dërguar nga DSIK-ja, në përfundim ka konstatuar se nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme. Sipas Komisionit, për kriterin e vlerësimit të figurës, subjekti është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

5. **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr.84/2016, Komisioni pasi ka administruar raportin e përgatitur nga Inspektoriat 5, ka vlerësuar se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”. Subjekti i rivlerësimit, z.Bashkim Dedja, për shkak të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit kushtetues, nuk përfshihet në programet e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, ndërsa është vetëtrajnuar pranë Shkollës së Magjistraturës.

6. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter rivlerësimi, Komisioni bazuar në gjurmën “a”, të pikës 1 të nenit 58, pika 1 e nenit 59 të ligjit nr.84/2016, *me shumicë votash*⁶, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z.Bashkim Dedja, kryetar i Gjykatës Kushtetuese.

7. Në vendimin nr.24 datë 13.06.2018, ka mbajtur mendim ndryshe, relatorja e çështjes, e cila ka konkluduar *se në pajtim me parashikimet e nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh provat e shqyrtuara dhe deklarinimet e bëra në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, nuk ka krijuar një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë, dhe për rrjedhojë, krijoj bindjen se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, por shkarkimin e tij nga detyra.*

⁴ “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “*proces i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë*”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit

⁵ Rishikimi i dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

⁶ Vendimi është marrë me një votë kundër të relatores së trupës gjyquese, zj.Xhensila Pine

II. Shkaqet e ankimit

I. Pasuria 1

1. Subjekti i rivlerësimit z. Bashkim Dedja, ka deklaruar në pronësi pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 98 m², pasuria numër *****, Zona kadastrale *****, ndodhur në rrugën “*****”, Tiranë. Deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit është bërë fillimisht në deklaratën vjetore të vitit 2003, me burim krijimi të ardhurat nga paga ime dhe të *****shtetasit ** në emigracion nga viti 1993 sipas pjesëve takuese 50 % me 50 %. Në Deklaratën Vetting në vitin 2017, kjo pasuri është deklaruar me burim krijimi nga kursimet dhe të ardhurat me pjesë takuese 100% të subjektit të rivlerësimit.

2. Lidhur me këto mospërputhje në deklarime, të cilat të çojnë në konkluzionin e deklarimit të pasaktë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime. Këtë pasuri do ta merrte së bashku me të *** pasi në vitin 1997 ishin ende në një trung familjar me të dhe ishin të pamartuar. Qëllimi fillestar ishte pagimi i pasurisë së mësipërme me kontributin e të dyve, pavarësisht faktit që kontrata e sipërmarrjes ishte bërë vetëm në emër të subjektit të rivlerësimit në vitin 1997, vit në të cilin është bërë edhe pagimi i kështit të parë të çmimit për ndërtimin e apartamentit objekt porosie. Më vonë **, i ***** i subjektit, mori dokumentat e qëndrimit në Greqi⁷, dhe u integrua atje, duke krijuar familje dhe nuk pati interes më të kthehej në Shqipëri dhe të ishte pjesëtar i kësaj banese. Subjekti, deklaroi se nuk ka dokumente për këtë, por ka bërë gjithçka me mirëkuptim, për shkak të marrëdhënieve të posaçme që ka me të *****. Si rrjedhojë kontrata e shitjes është në emër të subjektit të rivlerësimit dhe po ashtu edhe vërtetimi i pronësisë.

3. Komisioni konkludon se *“Krijimi i familjes dhe stabilizimi në shtetin grek konsiderohet nga trupi gjyqësor si një shpjegim i arsyeshëm në lidhje me kalimin e kontratës së sipërmarrjes në favor vetëm të subjektit të rivlerësimit”*

4. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga analiza e provave të administruara në fashikullin e Komisionit, dëshmohet deklarim i pasaktë i subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie përsa vijon :

4.1. Dispozitat ligjore të zbatueshme për deklarimin e pasurisë janë të parashikuara në Kushtetutë, ligjin 84/2016, udhëzimin e ILDKPKI-së të vitit 2016. Sipas pikës 2, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit duhet të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Ligji i posaçëm nr.84/2016, në pikën 1 të nenit 32, përcakton detyrimin e subjektit të rivlerësimit, që së bashku me deklaratën e pasurisë, të paraqesë të gjitha dokumentat që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të pasurive të deklaruara. Sipas udhëzimit nr.4095, datë 10.10.2016 e ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit duhet të depozitojë dokumentacion justifikues edhe në emër të personit të lidhur.

4.2. Sipas rregullimeve ligjore të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit në deklarimin e kësaj pasurie duhet të jepte një kronologji të detajuar të krijimit të saj ku të përshkruhej kontributi i ***** si burim krijimi, sasia e kontributeve të tij si dhe heqja dorë e tij nga kjo pasuri. Këto shpjegime do ti

⁷ Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në vitin 1998

shërbenin përmbushjes me korrektësi të detyrimeve ligjore të deklarimit të saktë dhe do të kursenin shpenzimet administrative gjatë procesit hetimor në Komision.

4.3 Arsyeja e stabilizimit në shtetin grek si shkak për heqjen dorë nga personi i lidhur ** nga pasuria nuk është e bazuar në prova. Nga dokumentacioni i administruar në fashikullin e Komisionit, rezultojnë konfirmime të Zyrës Vendore të Pasurisë së Paluajtshme *** dhe *****, sipas të cilave, *** ** ka investuar në pasuri të paluajtshme në Shqipëri pas vitit 1998. Investimet e bëra prej tij, tregojnë se arsyeja e stabilizimit në shtetin grek nuk është motiv për të humbur interesin për Shqipërinë. Gjithashtu, deklarimi se qëndrimi i rregullt filloi pas vitit 1998, bie në kundërshtim me Vërtetimin për periudhën kohore të qëndrimit të ligjshëm⁸ e paraqitur si provë prej subjektit që dëshmon vitin 2002.

5. Përsa i përket origjinës së krijimit të pasurisë rezulton se është blerë në vitin 2007. Sipas Kontratës⁹ blerës është subjekti i rivlerësimit dhe shitës *****¹⁰. Për çmimin e blerjes në kontratë thuhet se *“shuma prej 1.812,020 lekë është likuajduar plotësisht nga ana e blerësit në favor të sipërmarrësit ndërtues në afatet e përcaktuara në kontratën e porosisë individuale”*. Sipas kontratës individuale të porosisë¹¹, e muajit shkurt 1997, përcaktohet se shuma prej 19.600 USD do derdhet në llogarinë e të porositurit, sipas kësteve në vijim: *kësti i parë data 20.01.1997 që i përket 30 % e çmimit të përgjithshëm në shumën prej 588.000 lekë, kësti i dytë me arritjen e punimeve në katin e katërt në shumën 5.880 USD, kësti i tretë me fillimin e punimeve të rifiniturës në shumën 5.880 Usd dhe kësti i fundit në shumën 1.960 USD në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë”*. Përfundimi i punimeve të ndërtimit të pallatit ka qënë edhe objekt shqyrtimi gjyqësor për të vërtetuar faktin juridik të ndërtimit të një pallati në Rrugën “*****”. Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit ***, i datës **.11.1997¹², vërtetohet fakti juridik i ndërtimit të pallatit, dhe është administruar si provë proces-verbali i kolaudimit nr.***, datë ***.07.1997, i cili dëshmon se pallati ka qënë i përfunduar në muajin korrik 1997. Përsa i përket detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit ndaj firmës sipërmarrëse, sipas vërtetimit të datës **.04.2018, lëshuar nga firma “*****” sh.p.k subjekti i rivlerësimit ka shlyer sipërmarrësin në vlerën e plotë të çmimit të shitjes së apartamentit;

6. Në fashikullin e Komisionit nuk rezulton ndonjë e dhënë për kontributet respektive të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur **, në këstet e shlyera si dhe kohën e shlyerjes se tyre. Sipas dokumentacionit të cituara sa më lart, rezulton se pallati ka përfunduar në muajin korrik 1997, pasi në këtë muaj është lëshuar proces-verbali i kolaudimit dhe sipas kontratës individuale të porosisë duhet të jetë likuajduar edhe kësti i tretë i parashikuar me fillimin e punimeve të rifiniturës, pra shuma totale e shlyer në muajin korrik 1997 për këtë apartament duhej të ishte në vlerën prej rreth 17.000 USD (90% e vlerës së apartamentit).

7. **Subjekti i rivlerësimit** në shpjegimet e dhëna shprehet se *pagesa e këstëve është bërë ndaj firmës “*****” shpk në kohë të ndryshme se përndryshe nuk lidhej kontrata e shitjes, dhe se vërtetimet e*

⁸ Shkresa nr.prot.2018/989, nr.dosje 595, datë 12/04/2018, lëshuar nga *****

⁹ Kontratë nr.***, datë 21.08.2007 lidhur në Tiranë para Noterit *****.

¹⁰ Prona figuron e regjistruar sipas regjistrimit hipotekor me nr. *****, datë **.**.1997

¹¹ Kontratë nr.***, datë 07.02.1997 lidhur në Tiranë para Noterit *****

¹² Vendimi nr. *** me nr.*** Akti, ka marrë formë të prerë më datë **.11.1997

pagesës nuk i disponoj. Për mundësinë financiare për pagimin e këstit të parë më datë 20.01.1997, subjekti sqaron se sipas librezës së punës ka të ardhura që nuk janë llogaritur nga Komisioni dhe se shuma totale e të ardhurave personale rezulton të ketë qënë në vlerën 650 000 lekë , shumë që e tejkalon këstin prej 588 000 lekësh që është përcaktuar në kontratë për vitin 1997.

8. Subjekti i rivlerësimit lidhur me mundësinë financiare të ***** për të kontribuar në këtë pasuri ka deklaruar se në periudhën kur është paguar kësti i parë i apartamentit ** ka qënë emigrant në Greqi, fakt që vërtetohet me vërtetim përkatës të Njesisë Administrative ***** , dhe se ka qënë ndër të parët emigrant që ka marrë leje qëndrimi dhe punësimi në Greqi dhe se nga viti 1993-1998 ka qënë me qëndrim të paligjshëm në shtetin grek ashtu sikurse mijëra shqiptarë në Europë dhe nga viti 1998 me qëndrim të ligjshëm. Për të vërtetuar se ka qënë emigrant ka depozituar një vërtetim të Njesisë Administrative *****.

9. Komisioni lidhur me mundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie arsyeton se :

9.1. shuma totale e të ardhurave personale të subjektit rezulton të ketë qënë në vlerën 650 000 lekë . Kjo shumë vërehet se është më e madhe se kësti i pagesës prej 588 000 lekësh, që ishte përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes për vitin 1997. (shih faqe 9, fjalia 7)

9.2.objekti i hetimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është kontrolli i pasurive të deklaruara gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësuar dhe jo kontrolli i deklaratave të pasurisë të bëra gjatë viteve, gjatë kryerjes së detyrës, së parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës për subjektet e rivlerësimit. (shih faqe 9, fjalia 8)

9.3. “...vlerëson se shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit çmohen të arsyeshme dhe do të pranohen dhe për rrjedhojë do të konsiderojë edhe kontributin e ***** të tij për pagimin e çmimit që rrjedh si rezultat i nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nga ana e subjektit të rivlerësimit..” (faqe 9, fjalia 12) .

9.4. meqenëse të ardhurat nga paga e ***** të subjektit janë realizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është e kuptueshme që ***** i subjektit nuk kishte ndonjë detyrim për të deklaruar të ardhurat e realizuara në shtetin grek, dhe rrjedhimisht nuk shihet ndonjë shkak që këto të ardhura të realizuara nga *** i subjektit deri në vitin 1997 të konsiderohen si të ardhura të paligjshme (shih faqe 10 paragrafi 2);

9.5.deklarimi i të ardhurave bëhej nga personat rezidentë për të ardhura mbi 4.000 lekë në muaj, të realizuara nga burime në Shqipëri dhe jashtë saj. Persona rezidentë konsiderohen personat që qëndrojnë në Shqipëri për të paktën 183 ditë gjatë vitit tatimor. Detyrimi për mbajtjen dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat i përkiste punëdhënësit dhe jo punëmarrësit. Ky ligj ka qënë në fuqi deri në shfuqizimin e tij nga ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Prandaj, dhënia e parave nga një person tjetri, në legjislacionin shqiptar tatimor nuk gjen asnjë përcaktim si realizim të ardhurash të tatueshme nga individi nga burimet që krijohen të ardhurat (shih faqe 10, paragrafi 2);

9.6.mospërfshirja e një burimi që ka ekzistuar më parë, por që nuk ekziston më në momentin e deklaramit në formularin e vetting-ut, i cili ka për objekt vetëm deklaramin e pasurive ekzistuese, çmohet se nuk përbën shkak për fshehje të pasurisë apo deklaram të pasaktë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe sipas nenit 30 e vijues të ligjit 84/2016 (shih faqe 10, paragrafi 3)

10. Në përfundim Komisioni konkludon :

10.1 Ka pasaktësi në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” dhe deklarimet ndër vite lidhur me pagesën e kryer për blerjen e këtij apartamenti, por subjekti i ka sqaruar këto pasaktësi. Referuar kohës kur kjo pasuri është blerë, vitit 1997, çdokush mund të gjendet në situata të pamundësisë për të qenë i saktë në deklarime, por sqarimet e dhëna treguan se subjekti ka pasur mundësitë financiare për të blerë këtë pasuri të paluajtshme dhe se pasaktësitë nuk kanë qenë të qëllimshme.

10.2 Shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pronë përputhen me të dhënat e administruara.

11. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat që dëshmojnë pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur ** për blerjen e kësaj pasurie janë si vijon:

11.1. Pasuri dhe të ardhura të ligjshme sipas pikës 3 të Nenit D të Kushtetutës do të quhen ato që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për elementë të tjerë të pasurisë së ligjshme pika 3 vazhdon dhe sanksionon se përcaktohen me ligj. Për qëllim të zbatimit të këtij parashikimi kushtetues në rastin tonë shtrojmë dy pyetje:

a) Sa janë të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie?

b) Sa janë të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur **. për blerjen e kësaj pasurie?

11.2 Sipas dokumentacionit ligjor të administruar, sikurse parashtruam më sipër, deri në korrik 1997, shuma e paguar për apartamentin sipas kontratës individuale të porosisë duhet të ishte rreth 17 000 USD, në mungesë të të dhënave mbi kohën e kryerjes së pagesave për hir të analizës financiare do të përqëndrohemi në mundësinë financiare për pagimin e këstit të parë që përkon me datën 20.01.1997. Nga të dhënat e disponuara konstatojmë se subjekti i rivlerësimit, nuk ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme që të paguante këstin e parë të apartamentit, në shumën 588.000 lekë. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të ardhurat e ligjshme të subjektit, bazuar në përcaktimet e pikës 3 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Tabela Nr. 1 Të ardhura të ligjshme të subjektit për periudhën 1994 - 1996

	Të ardhura nga paga neto	1994	1995	1996	Totali
1	Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë	46,807	205,866	164,030	416,703
2	Gjykata Apelit Tiranë			93,520	93,520

Gjithsej	46,807	205,866	257,550	510,223
-----------------	---------------	----------------	----------------	----------------

Pra, totali i të ardhurave të ligjshme të subjektit për periudhën 1994 – 1996, është në vlerën 510. 223¹³ lekë, ndërsa shuma që subjekti duhej të paguante pranë firmës ndërtuese është në vlerën 588.000 lekë. Subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të paguar këstin e parë.

11.3 Ka mospërputhje në deklaratimet e bëra ndër vite pasi në *deklaratën periodike të interesave të vitit 2003 subjekti deklaroi që ka detyrim ndaj firmës ndërtuese “*****” sh.p.k, në shumën 200.000 lekë, ndërsa në deklaratën e vitit 2005 subjekti ka deklaruar detyrimin 2.600 USD, i cili detyrim bazuar në deklaratat vjetore në vazhdim, nuk figuron të jetë shlyer. Gjithashtu, në deklaratën e vitit 2003, subjekti ka deklaruar vlerën e apartamentit në shumën 1.700.000 lekë, ndërsa referuar kontratës është 1.812.020 lekë.*

11.4. Për sa më sipër, vlerësojmë se subjekti është në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj pasurie, si rrjedhojë ka kryer deklaram të pasaktë për pasurinë si dhe për detyrimet financiare në deklaratën e pasurisë së vitit 2003.

11.5 Fillimisht para se të analizojmë të ardhurat e ligjshme për personin e lidhur **, duhet të identifikojmë normën ligjore të zbatueshme për të ardhurat e realizuara në një shtet të huaj. Sipas “parimit të rezidencës” që udhëheq shumicën e legjislacioneve tatimore në shumicën e vendeve të botës, të ardhurat nga punësimi tashmë në vendin e burimit, ku ushtrohet puna. Për të përcaktuar “rezidencën”, shqyrtuam vërtetimin e paraqitur nga Njësia Administrative ***, që deklaroi vitin 1993 si fillim të emigracionit dhe e ballafaqojmë me vërtetimin e lëshuar nga autoritetet greke për qëndrimin e rregullt në Greqi që dëshmon vitin 2002. Kontradiktat në vite si dhe konsiderata se kush e ka lëshuar vërtetimin të çojnë në përfundimin se personi i lidhur ** nuk ka qënë rezident në shtetin grek për qëllime tatimore.

11.6 Të ardhura të ligjshme të **** të subjektit, do konsideroheshin të ardhurat për të cilat i **** ka paguar detyrimet tatimore në shtetin ku ka punuar, dhe ne nuk jemi në kushtet ku duhet të bëjmë interpretim të të ardhurave të ligjshme të personit të lidhur mbi bazën sesa ka deklaruar në shtetin shqiptar apo a kishte detyrimin të deklaronte në shtetin shqiptar.

11.7 Konstatimi përgjithësues i Komisionit se “*dhënia e parave nga një person te tjetri në legjislacionin shqiptar tatimor nuk gjen asnjë përcaktim si realizim të ardhurash të tatueshme nga individi nga burimet që krijohen të ardhurat, “¹⁴ është në kundërshtim me ligjin nr.8438/viti 1998”Për tatimin mbi të ardhurat”, ku përcaktohet se si burim të ardhurash do të jenë “të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen” (neni 4/i) dhe se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme “ të ardhurat nga ...huaja” (neni 8, pika 1/d).*

11.8 Deklarata noteriale e shtetasit Grek¹⁵, punëdhënësit të personit të lidhur **, vihet në dyshim për shkak të referimit të punësimit të personit të lidhur ** nga viti 1998 ndërkohë që qëndrimi i rregullt i tij ka filluar në vitin 2002, sikurse sqaruam në paragrafin 4.3.,. Gjithashtu këtu po shqyrtojmë

¹³ Kjo shumë është totali i të ardhurave të subjektit nga paga, ku nuk janë zbritur shpenzimet jetësore të subjektit për këtë periudhë.

¹⁴ Referohu vendimit të Komisionit fq.10, paragrafi 2

¹⁵ Referohu dosjes se pyetesorëve, në të cilën ndodhet deklarata e punëdhënësit në Greqi.

mundësitë financiare të personit të lidhur ** për periudhën deri në vitin 1997 e cila është në interes të trajtimit të kësaj pasurie. Gjithashtu në fashikullin e Komisionit, në interes të analizës financiare për të ardhurat e ligjshme të personit të lidhur ** nuk ka dokumenta që të japin informacion mbi të ardhurat e minimumit jetik në atë periudhë në shtetin grek, apo të ardhurat mesatare për shtetasit grekë, bazuar në të dhënat statistikore të shtetit fqinj për atë periudhë.

11.9 Për sa më sipër, vlerësojmë se personi i lidhur ** është në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj pasurie, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë për kontributin e ** ** në blerjen e pasurisë

11.10 Komisioni është shprehur se: ” Në këto kushte, mospërfshirja e një burimi që ka ekzistuar më parë, por që nuk ekziston më në momentin e deklaramit në formularin e vetting-ut, i cili ka për objekt vetëm deklaramin e pasurive ekzistuese, çmohet se nuk përbën shkak për fshehje të pasurisë apo deklaram të pasaktë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe sipas nenit 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016”¹⁶, është një arsyetim i gabuar në vlerësimin e Komisionerit publik pasi në kuptim të rregullimeve ligjore sipas të cilave deklarami i pasurisë në shtojcën “Vetting”, sipas shpjegimeve sqaruese të saj ka për objekt : “...të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e dorëzimit të deklaramtës ..., burimet e krijimit të tyre...”, pra nuk e lidh burimin e krijimit të pasurisë me afate kohore, por e trajton atë (burimin) si shkak për të justifikuar ligjshmërinë e këtyre pasurive, i cili në rrjedhë logjike duhet të përputhet me sa kanë deklaramuar subjektet ndë vite, në mënyrë që të jemi përballë kushteve të nenit 32 të ligjit 84/2016 dhe të justifikohet vërtetësia e deklarameve të subjektit.

11.11 Gjithashtu në kontradiktë me këtë kuptim të normës ligjore, Komisioni shprehet se “ Objekt i hetimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është kontrolli i pasurive të deklaramuara gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të subjektit të rivlerësuar dhe jo kontrolli i deklaramave të pasurisë të bëra gjatë viteve, gjatë kryerjes së detyrës, së parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës për subjektet e rivlerësimit ¹⁷“, kuptim që vjen në kundërshtim të hapur me nenin 32 pika 5, të ligjit 84/2016 ku thuhet, “ Deklaramat e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitit”.

II. Pasuria 2

1. Subjekti i rivlerësimit z. Bashkim Dedja, ka deklaram në pronësi pasuritë e llojit “apartament banimi 146 m²” dhe “garazh 15.25 m²”, respektivisht me numrat e pasurive ***** dhe ***** , Zona kadastrale ***** , ndodhur në rrugën “*****“ Tiranë. Deklarami i pasurisë nga ana e subjektit është bërë fillimisht në Deklaramtën Vjetore të vitit 2013, me burim krijimi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, kredi bankare nga *****, hua pa interes nga shtetasi *** (*****), hua pa interes nga shtetasi ** (*****) me pjesë të ndarë në % me bashkëshorten. E njëjta pasuri është deklaram në vitin 2017 në Deklaramtën Vetting me të njëjtin përshkrim.

¹⁶ Shih faqe 10 të vendimit , paragrafi 3

¹⁷ Referohu faqe 9 e vendimit.

2. Përsa i përket origjinës së krijimit të pasurisë së llojit “apartament” me sipërfaqe 146 m², rezulton se sipas Kontratës së shitjes me rezervë¹⁸, të datës 1 nëntor 2013, subjekti i rivlerësimit z. Bashkim Dedja si blerës dhe “*****” sh.p.k si shitës kanë rënë dakord për çmimin e blerjes në shumën totale prej Euro 168,000 (një qind e gjashtëdhjetetë mijë). Në kontratë thuhet se: *të dyja palët kanë rënë dakord që çmimi i i shitjes të likuidohet më këste¹⁹ dhe pjesërisht me kredi bankare²⁰*. Shitësi ka deklaruar se Blerësi i ka likujduar paraprakisht këstin e parë dhe të dytë, përpara nënshkrimit të Kontratës, jashtë zyrës noteriale, nëpërmjet veprimeve bankare “*****” e datës ** tetor 2010 dhe “*****” e datës **.10.2013.

3. Përsa i përket origjinës së krijimit të pasurisë së llojit “garazh” me sipërfaqe 15. m², rezulton se sipas Kontratës së shitjes me rezervë²¹, të datës 1 nëntor 2013, subjekti i rivlerësimit z. Bashkim Dedja si blerës dhe “*****” sh.p.k si shitës kanë rënë dakord për çmimin e blerjes në shumën totale prej Euro 12,000 (dymbëdhjetë mijë). Në kontratë thuhet se : *të dyja palët kanë rënë dakord që çmimi i i shitjes të likuidohet më këste²² dhe pjesërisht me kredi bankare²³*. Shitësi ka deklaruar se Blerësi i ka likujduar paraprakisht këstin e parë, përpara nënshkrimit të Kontratës, jashtë zyrës noteriale, nëpërmjet “*****”, datë *** tetor 2013 e kryer në bankën e nivelit të dytë “*****” sha.

4. Sipas Kartelave të pasurisë rezulton se regjistrimi në hipotekë i këtyre pasurive figuron të jetë bërë më datë 07.11.2013, përpara datës 03.12.2013 kur është bërë disbursimi i kredisë. Nga verifikimi i transaksioneve të kryera për blerjen e apartamentit dhe garazhit, konstatojmë se në emër të subjektit²⁴ janë kryer derdhje cash për llogari të shoqërisë **** sh.p.k. në datë **.10.2013 ora **:**, në degën ****, në arkën ****, të **, shuma 5000 euro dhe në datë 28.10.2013 ora 12:06, në degën 0.100, në arkën ****, të ***** shuma 5000 euro. Nga verifikimi i pagesave të tjera për blerjen e apartamentit, vërejmë se në datë 29.10.2013, subjekti ka kryer një derdhje cash pranë ***** në shumën 7.000.000 (shtatëmilion) lekë, të cilën me anë të transfertës bankare subjekti e kalon në llogarinë e **** sh.p.k., me përshkrim “*****”.

5. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna për huanë pa interes marrë nga **** shprehet se:

5.1. **** nga viti 2002 e në vazhdim jeton e punon në Itali. Për një periudhë kohore ai nuk ka patur dokumente të rregullta qëndrimi, për pasojë nuk ka siguruar dot kontrata punësimi, por është paguar nga punëdhënësi me para kesh për punën që ka kryer. Gjithashtu edhe pasi është pajisur me lejeqëndrimi kanë vazhduar ta paguajnë pjesërisht me para kesh dhe pjesërisht nëpërmjet pagesave bankare.

5.2.Për të provuar marrëdhënien e huasë subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur Deklaratës Vetting Deklaratën noteriale e datës ** mars 2014, me palë subjektin e rivlerësimit z. Bashkim Dedja dhe shtetasin **. ku deklarohet se “Zoti ***** i ka dhënë hua më datë 10.10.2013

¹⁸ Kontratë me nr.*****, e datës 1 nëntor 2013 e lidhur në Tiranë para Noterit *****

¹⁹ Kësti i parë Euro 5 000 (pesë mijë)

²⁰ Transferimi jo më vonë se data 30 dhjetor 2013

²¹ Kontratë me nr.334 rep, nr.179/5 kol, e datës 1 nëntor 2013 e lidhur në Tiranë para Noterit *****

²² Kësti i parë Euro 5 000 (pesë mijë), Kësti i dytë Euro 50 000 (pesëdhjetë mijë)

²³ Tansferimi jo më vonë se data 30 dhjetor 2013

²⁴ Derdhja në llogari është bërë nga dy persona të ndyshëm nga subjekti

*** të tij z. *Bashkim Dedja me hua pa interes për një periudhë pa afat shumë prej 10.000 Euro (dhjetë mijë Euro)*". Pas konstatimit të Komisionit se më datë 10.10.2013, datë kur është bërë Deklarata Noteriale, shtetasi *** nuk ka qënë në Shqipëri, subjekti i rivlerësimit shpjegon se " faktin e krijimit dhe të sjelljes së të ardhurave e ka konfirmuar nëpërmjet Deklaratës noteriale²⁵ babai i ** shtetasi *****, i cili i ka dorëzuar subjektit të rivlerësimit shumë e marrë hua pa interes nga ****.

6. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna për huanë pa interes marrë nga ** *** shprehet se:

6.1. Siç kam shpjeguar hollësisht më parë, *** *, është emigrant ekonomik në Greqi nga viti 1993 e në vazhdim... Duke punuar në emigracion, ai ka krijuar të ardhura të cilat i ka sjellë në Shqipëri, pavarësisht se nuk disponon dokumente zyrtare për këtë... Duke ju referuar situatës në Shqipëri pas vitit 1990, është një fakt që dihet tashmë se mbi 70% e familjeve shqiptare kishin të paktën një person në emigracion, pa dokumente, në vende të ndryshme si Greqi, Itali, Gjermani, Francë etj.. Ishin pikërisht të ardhurat e këtyre emigrantëve të paligjshëm që mbanin familjet e tyre në Shqipëri.

6.2.Për të provuar marrëdhënien e huasë subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur Deklaratës Vetting, Deklaratën noteriale të datës ** mars 2014, me palë subjektin e rivlerësimit z. Bashkim Dedja dhe shtetasin ** ku deklarohet se "*Zoti ***** i ka dhënë hua më datë **.08.2013 *** të tij z. Bashkim Dedja me hua pa interes për një periudhë pa afat shumë prej 15.000 Euro (pesëmbëdhjetë mijë Euro)*".

7. Komisioni lidhur me faktin e përcaktimit të aftësisë paguese të ** shprehet se:**

7.1. ..fakti se **** i subjektit të rivlerësimit z. ** nuk ka qënë ndonjëherë subjekt i deklarimit të të ardhurave, prandaj parashikimi i përcaktimit Kushtetues, i nenit D, pika 3, fjalia e dytë që i konsideron të ligjshme vetëm ato të ardhura që janë deklaruar dhe janë paguar detyrimet tatimore, nuk gjen zbatim ndaj këtij individ, për arsye se : së pari, ai nuk ka realizuar të ardhura në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, së dyti ai nuk ka qënë ndonjëherë subjekt i deklarimit të pasurive, nuk ka kryer ndonjëherë funksion zyrtar që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë (*shih faqe 14, paragrafi 1*);

7.2. ... nisur nga një periudhë relativisht e gjatë, nga viti 2002 deri në vitin 2013, kur i ka dhënë huanë e sipërpërmendur, pra për një periudhë 10 vjeçare , z. ** mund të kursente të paktën shumë prej 1000 eurosh për çdo vit, duke i dhënë ato hua pa kundërshtim për subjektin e rivlerësimit;

8. Në përfundim Komisioni konkludon :

8.1. Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara

8.2. ***** ka patur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huanë në shumë e sipërpërmendur.

²⁵ Deklaratë noteriale ***** kol datë 13.04.2018

9. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat që dëshmojnë mungesën e burimeve financiare të ligjshme të ***** për blerjen e kësaj pasurie dhe deklarimin e rremë janë si vijon:

9.1. Fillimisht në përputhje me parashikimin e nenit 3, pika 14²⁶ të ligjit nr.84/2016, shtetasi ***, duke qenë se ka patur lidhje interesi që rrjedh nga një interes pasuror (marrëdhënia e huasë) kualifikohet si person tjetër i lidhur. Në zbatim të nenit 32 pika 4²⁷ të ligjit 84/2016, duke qenë se me Deklaratën Noteriale konfirmon marrëdhënien e huasë ka detyrimin e justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave.

9.2. Me Deklaratën Noteriale të *** marsit 2014, deklarohet fakti i marrëdhënies së huasë për shumën 10 000 Euro të marrë më 10 tetor 2013. Për datën e marrjes së huasë subjekti i rivlerësimit shprehet *“se nuk e kujton datën e saktë të marrjes së huasë, dhe nëse ishte e njëjtë me atë të deklaratës noteriale”*. Për mënyrën e marrjes së shumës 10 000 Euro babai i personit tjetër të lidhur *** shprehet se *“...” në tetor të vitit 2013 pasi u konsultova edhe me ***** , nga kursimet tona familjare i kam dhënë shtetasit z.Bashkim Dedja, bashkëshort i * *****, një hua prej 10.000 euro për arsye se bleu një shtëpi të re..”*. Sipas këtyre rrethanave të paraqitura të ngjarjes është e pakonceptueshme që subjekti i rivlerësimit, në detyrën funksionale që mban, tregohet aq i “pakujdeshëm” sa nuk vlerëson drejt atë çfarë deklaron dhe firmos nën përgjegjësinë e tij të plotë pranë një zyre noteriale. Konfirmimi i faktit që huaja është dhënë nga i ati i personit tjetër të lidhur ***, mund të ishte shprehur shumë mirë në përmbajtjen e asaj deklarate. Në kushtet kur kjo deklaratë lidhej qëllimisht për dokumentimin e huasë për *periudhën Tetor* që korrespondon me kohën kur lekët i duheshin subjektit, palët nuk mund të nënshkruanin një akt noteriale që nuk pasqyronte vërtetësinë e të dhënave të deklaruara.

9.3. Natyra e deklaratës noteriale, si provë shkresore, është me fuqinë e akteve autentike,²⁸ dhe duke shqyrtuar deklaratën respektive shprehet qartazi se *kjo deklaratë i është lexuar palëve me zë të lartë dhe të qartë dhe se ato kanë deklaruar se e dëgjuan, e kuptuan, dhe gjejnë të shprehur vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë*. Në këto kushte, vlerësojmë se jemi para një deklarimi të pasaktë dhe të rremë lidhur me sa subjekti ka deklaruar dhe nënshkruar.

9.4 Komisioni arsyeton se parashikimi Kushtetues për të ardhurat e ligjshme²⁹ nuk gjen zbatim për personin tjetër të lidhur ** pasi ai nuk ka realizuar të ardhura në territorin shqiptar dhe nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë. Ky arsyetim është i cekët dhe nuk qëndron, pasi parimet që udhëheqin shumicën e legjislacioneve tatimore³⁰ janë të njëjta dhe një ndër këto parime është edhe ai i “residencës” sipas të cilit të ardhurat nga punësimi taten në vendin e burimit, ku ushtrohet puna. Në këtë kuptim personi tjetër i lidhur duhet të dëshmojë kapacitetin financiar për të dhënë shumën e huasë, kapaciteti i cili nuk del sipas hamendësimeve apo sofizmave të llojit *“mund të kursente të paktën shumën*

²⁶ “14. “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisioner-in, gjyqtarin ose komisioner-in publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

²⁷ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive

²⁸ Neni 40 i Ligjit për noterinë

²⁹ Janë ato që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore

³⁰Shih në faqen zyrtare të DPTT <https://www.tatime.gov.al/c/6/69/procedurat-tatimore>

prej 1000 eurosh për çdo vit , duke i dhënë ato hua pa kundërshpërblim”, por bazuar në një analizë financiare.

9.5 Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur **, janë deklarata të punëdhënësve në Itali dhe jo nga autoritetet kompetente italiane të cilat dëshmojnë pagimin e taksave në shtetin italian. Në rend kronologjik të ardhurat sipas viteve janë: viti 2010 pagë neto 8855.30 euro³¹, viti 2011 pagë neto 8936 euro³², viti 2012 pagë bruto 11 450 euro³³, viti 2013 pagë bruto 12 753.51 euro³⁴, viti 2014 pagë bruto 6541.23 euro³⁵.

9.6 Konstatohet se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen të ligjshme, pasi nuk janë lëshuar nga autoritetet zyrtare italiane, të cilat të vërtetojnë pagimin e taksave në shtetin Italian. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar në Komision një dokument “*Ekstrakt i Llogarisë së Sigurimeve Ligjore*”, i cili përmban shënimin“...nuk jepet për Organet e Administratës Publike...”, dhe si i tillë nuk mund të vërtetohet ligjshmërinë e të ardhurave në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pra, subjekti megjithëse ka patur barrën e provës, nuk ka dokumentuar se ****i tij ka patur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme, me të cilat mbulohet huaja prej 10.000 euro, e përdorur për blerjen e apartamentit.pasqyron sa më poshtë.

Tabelë nr.2

**** kodi fiscal: *****, me banim në *****

Periudha		Kontribut i dobishëm për pension	Që duhet për llogaritjen			Lireta	Euro
Nga	Deri						
1/1/2003	31/12/2003	Bujk ditor	Ditë	51	510,000	4,360,477	2,244.11
1/2/2004	31/12/2004	Bujk ditor	Ditë	39	39,000	3,293,188	17,009.79
1/2/2005	31/12/2005	Bujk ditor	Ditë	52	52,000	4,390,918	2,267.72
1/5/2008	31/12/2008	Bujk ditor	Ditë	6	6,000	493,557	258.00
1/5/2009	31/12/2009	Bujk ditor	Ditë	10	10,000	887,497	510.00
1/6/2012	31/12/2012	Bujk i paguar (argat)	Ditë	250	260,000	20,636,201	10,761.00

10. Komisioni lidhur me faktin e përcaktimit të aftësisë paguese të *** *** shprehet njëjloj si në pikat 7.1 dhe 7.2 më lartë dhe shton se :

10.1. ..rezulton e provuar se *** i subjektit të rivlerësimit ka realizuar të ardhura nga puna dhe kursimet e tij, së bashku me familjen në shtetin grek... e provuar kjo edhe me deklaratimet e punëdhënësit në shtetin grek , të cilat justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave (faqe 15, fjalja e dytë dhe e tretë)

11. Në përfundim Komisioni konkludon :

³¹ Deklaratë Zëvendësuese *** 2010, datë 31.03.2011

³² Deklaratë Zëvendësuese *** 2011, datë 31.03.2012

³³ Deklaratë Zëvendësuese ***, date 10.02.2018

³⁴ Deklaratë Zëvendësuese ***, date 10.02.2018

³⁵ Deklaratë Zëvendësuese ***, date 10.02.2018

11.1. *** i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huanë në shumën e sipërpërmendur (faqe 15, paragrafi 2)

11.2. Lidhur me përcaktimet e parashikuara në nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, referuar konceptit të pasurisë së ligjshme për qëllime të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se dispozita i referohet subjektit të rivlerësimit dhe, në rastin në fjalë, huaja e marrë është një detyrim, i cili do të zëvendësohet nga subjekti i rivlerësimit, me kthimin e saj, me të ardhurat e vetë subjektit të rivlerësimit, të cilat duhet të jenë sipas përcaktimeve të kësaj dispozite. Vetëm me shlyerjen e huasë dhe kredisë bankare, prona do të jetë e subjektit të rivlerësimit dhe burimi i krijimit të saj do të jetë nga të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës (faqe 15, paragrafi 4).

12. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat që dëshmojnë mungesën e burimeve financiare të ligjshme të ***** për blerjen e kësaj pasurie janë si vijon :

12.1. Fillimisht në përputhje me parashikimin e nenit 3, pika 14³⁶ të ligjit nr.84/2016 , shtetasi *** , duke qenë se ka patur lidhje interesi që rrjedh nga një interes pasuror (marrëdhënia e huasë) kualifikohet si person tjetër i lidhur. Në zbatim të nenit 32 pika 4³⁷ të ligjit 84/2016, duke qenë se me Deklaratën Noteriale konfirmon marrëdhënien e huasë ka detyrimin e justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave.

12.2. Përfundimi i Komisionit i cituar në pikën 11.2 më lartë vjen si rrjedhojë e një arsytimi mekanik dhe në vlerësimin tonë kuptimi “të mangët“ të legjislacionit për rivlerësimin kalimtar dhe në kundërshtim të hapur si me frymën e dispozitave kushtetuese për procesin e rivlerësimit po ashtu me nenin 3 pika 19³⁸ dhe nenin 32 pika 4³⁹ të ligjit 84/2016 ku nuk bëhet një ndarje e tillë si ajo e Komisionit përsa i përket konceptit të pasurisë së ligjshme.

12.3 Komisioni arsyeton se parashikimi Kushtetues për të ardhurat e ligjshme⁴⁰ nuk gjen zbatim për personin tjetër të lidhur *** pasi ai nuk ka realizuar të ardhura në territorin shqiptar dhe nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë. Ky arsyetim është “i cekët” dhe nuk qëndron, pasi parimet që udhëheqin shumicën e legjislacioneve tatimore⁴¹ janë të njëjta dhe një ndër këto parime është edhe ai i “residencës” sipas të cilit të ardhurat nga punësimi taten në vendin e burimit, ku ushtrohet puna. Në këtë kuptim personi tjetër i lidhur, duhet të dëshmojë kapacitetin financiar për të dhënë shumën e huasë, kapacitet i cili nuk del sipas hamendësimeve apo sofizmave të llojit “*mund të kursente të paktën*

³⁶ “14. “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

³⁷ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive

³⁸ “Të ardhura të ligjshme “janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur

³⁹ “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose personat e tjerë të lidhur ... kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”

⁴⁰ janë ato që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore

⁴¹Shih në faqen zyrtare të DPTT <https://www.tatime.gov.al/c/6/69/procedurat-tatimore>

shumën prej 1000 eurosh për çdo vit , duke i dhënë ato hua pa kundërshpërblim”, por bazuar në një analizë financiare.

12.4 Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur **, janë deklarata e një shtetasi grek në cilësinë e punëdhënësit dhe vërtetimi për qëndrimin e ligjshëm në shtetin grek. Këto dokumenta përplasen me njëra –tjetrën në elementin vit, sipas Vërtetimit të lëshuar nga organi kompetent i shtetit grek qëndrimi i ligjshëm fillon në vitin 2002, sipas punëdhënësit grek personi tjetër i lidhur ka filluar punë në vitin 1998. Për të vërtetuar pagesat e deklaruara nga punëdhënësi grek, nuk është paraqitur dokument zyrtar që do të provonte si të ligjshme pasi nuk mund të shërbej një deklaram i një qytetari si provë për ligjshmërinë e të ardhurave. Konstatohet se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen të ligjshme, pasi nuk janë lëshuar nga autoritetet zyrtare greke, të cilat mund të vërtetojnë pagimin e taksave në shtetin Grek.

12.5 Sipas dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, vërejmë se personi tjetër i lidhur **, ka kontribuar në disa pasuri në Shqipëri, herë veçmas dhe herë në pronësi me *****. Më poshtë gjenden të listuara pasuritë.

Tabele nr.3
*Kontributet në investime e personit të lidhur *** periudha 1998 - 2014* *LEK*

1	Dhënë hua subjektit për shtëpinë e banimit në Tiranë Pall. *****	Euro	15,000	2,014,800
2	Shtëpia e ***** - deri në vitin 2003 pjesë 50% ⁴²	USD	8,500	981,920
3	Dhuruar ***** (sipas deklaratës së subjektit 2003) ⁴³	GRD	50,000	18,060
4	Shtëpia e ***** (kontribuar me *****) ⁴⁴	lek	950,000	950,000
5	Tokë në fshatin ***** 2000 m ² (kontribuar *** 50%)	lek	450,000	450,000
6	Kontribuar në blerjen e makinës së subjektit sipas deklaratës 2003, 50% ⁴⁵	lek	175,000	175,000
7	Apartament në ***** Tiranë, viti 2014	Euro	42,000	5,765,760
	Pasuria në total			10,355,540
	Marrë kredi pranë ***** për të blerë Apartamentin/***** ⁴⁶ 2014	Euro	25,000	3,432,000

12.6 Nga tabela e mësipërme është e kuptueshme se ** i subjektit ka investuar në Shqipëri gati 10.355.540 Lekë. Madje figuron se në vitin 2014, ka marrë kredi pranë ***** në shumën 25.000 euro, ndërkohe që i kishte dhënë të ***, subjektit të rivlerësimit, hua pa interes në shumën 15.000 euro.

12.7 Si përfundim, vlerësojmë se subjekti nuk paraqiti dokumentacion që të mund të vërtetoj mundësinë e aftësisë paguese të personave të tjerë të lidhur, si dhe paraqiti rrethana dhe fakte kontradiktore dhe të pa sakta.

⁴² Bazuar në deklarinimin e subjektit DV 2003, kontributi i ***** deri në atë periudhë 50%

⁴³ Bazuar në deklarinimin e subjektit DV 2003, dhuratë nga ***

⁴⁴ Bazuar në deklaratën noteriale të ***** që kjo shtëpi është blerë bashkërisht me ***

⁴⁵ Bazuar në deklarinimin e subjektit në DV 2003

⁴⁶ Bazuar në Kontratën e Shitblerjes Nr. 1394 Rep; Nr 799/1 Kol. Datë **.08.20014

12.8 Gjithashtu Komisioneri Publik shikon të çuditshëm faktin që subjekti i rivlerësimit morri hua nga **** dhe *** i tij, ndërkohë që mund të kishte shitur Apartamentin me sipërfaqe 98 m2 ndodhur në rrugën *****.

III. Pasuria 3

1. **Subjekti i rivlerësimit Bashkim Dedja**, në përgjigje të pyetësorit të hartuar nga Komisioni⁴⁷, lidhur me faktin nëse ka përdorur në shtatë vitet e fundit pasuri të regjistruara në emrin e dikujt tjetër, ka deklaruar sa më poshtë citojmë ”...kam përdorur herë pas here me ditë, një apartament dhomë e kuzhinë në pronësi të ****, të ndodhur te *****, **** *”

2. Pika 11 e nenit 3 të ligjit 84/2016, jep përkufizimin e termit “pasuri”⁴⁸, për të cilën subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin ligjor për ta deklaruar dhe në shtojcën “Vetting”. Subjekti nuk e ka deklaruar një fakt të tillë në deklaratën “Vetting”, të cilin e ka deklaruar vetëm në përgjigje të pyetjeve të pyetësorit të realizuar nga Komisioni.

3. Subjekti ka shpjeguar se ai nuk ka deklaruar se ka një apartament në përdorim, por ka thënë,- *për të qenë sa më transparent- se e ka përdorur ndonjëherë me ditë, gjatë pushimeve të verës,- dhe kjo shprehje nuk nënkupton se ka pasur një marrëdhënie juridike të tillë, për përdorimin e sendit, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil. Komisioni ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, dhe ka cituar se...veprimi juridik i “përdorimit të sendit” që parashikojnë dispozitat e Kodit civil nuk ekziston, duke justifikuar mos deklarin e subjektit të një **të drejte reale** që faktikisht subjekti e ka mbi sendin.(Vendosim në vëmendje këtu detyrimin për të deklaruar dhe të drejtat e tjera reale, përveç pronësisë).*

4. Vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e nenit 259 të Kodit Civil ku thuhet se *...Personi që ka një të drejtë thjesht përdorimi mbi një send, e përdor atë dhe gëzon frutet e tij në masën që ka nevojë për vete e për familjen e tij. Kur objekti i të drejtës së përdorimit është një banesë, personi ka të drejtë të banojë atje sipas nevojave të tij e të familjes së tij. Sendi ose banesa që përdoret sipas kësaj dispozite nuk mund të tjetërsohet, të rëndohet dhe as të përdoret nga persona të tjerë.*

5. Kodi Civil në nenin 162 të tij, përcakton se e drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës. E drejta e përdorimit të banesës, *qoftë dhe vetëm herë pas here*, mund t’i transferohej subjektit vetëm nga pronari, i cili ka i vetëm tagrin ligjor për të transferuar çdo të drejtë reale mbi sendin. Fakti që subjekti ka përdorur sipas nevojave të tij dhe familjes së tij e bën atë përdorues dhe në kuptim të Kodit Civil, *dhe si mbartës i një të drejte reale mbi sendin kishte padiskutim detyrimin ligjor ta deklaronte.*⁴⁹

⁴⁷ Referohu, pyetësorit nr.1 në dosje të Komisionit

⁴⁸ “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

⁴⁹ Objekt deklarimi sipas nenit 4 , pika 1 “a” , të ligjit 9049/2003 janë : *pasuritë e luajtshme dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil*

6. Pavarësisht cilësimeve, qëndrimeve dhe interpretimeve ligjore mbi këtë fakt, konstatohet se subjekti dhe pas realizimit të pyetësorit nga Komisioni, sërish ka qenë i paplotë mbi deklaratimet e të drejtave dhe detyrimeve që ka mbi këtë apartament.

7. Sipas dokumentacionit të gjendur në fashikullin e Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka në emër të tij një kontratë furnizimi me energji elektrike me OSHEE, të lidhur me datë 12.11.2004, për një apartament në ****.

8. Duke qenë se nga e ana subjektit vazhdojnë të paguhen faturat e energjisë elektrike për këtë apartament, atij iu kërkuan shpjegime, në të cilat parashtroi se “.....kontrata e enrgjisë elektrike për këtë apartament është bërë në emrin tim për lehtësi pagese, sepse unë në atë kohë punoja në ****, ndërsa **** jetonte në Greqi. Fillimisht faturat e energjisë janë paguar në ***, ***** dhe më pas kur pagesat u futën në sistem online, ato janë paguar në Tiranë. Emri im në kontratë ka mbetur që atëherë, dhe nuk është ndryshuar për inerci dhe neglizhencë, pasi dhe aktualisht ***** vazhdojnë të jetojnë njëri në **** dhe tjetri në *****....”

9. Komisioni për shtetasin *** arsyeton se :

9.1. subjekti i rivlerësimit nuk ka patur ndonjë të drejtë reale, siç është ajo e përdorimit mbi pasurinë që zotërohet dhe administrohet nga pronari i saj. Fakti që këtë pasuri e ka përdorur vetëm për një periudhë të caktuar edhe subjekti i rivlerësimit nuk do të thotë se mbajtja e sendit përkohësisht, që i përket **** është një e drejtë reale, siç është ajo e përdorimit të sendit për vete,

9.2...e vetmja gjetje që ekziston ndaj subjektit të rivlerësimit është se ai ka marrë përsipër të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e energjisë e kësaj pasurie, që është regjistruar në emër të **** të tij⁵⁰;

9.3. Në të tilla kushte, përderisa subjekti i rivlerësimit nuk ka një marrëdhënie huaje, dhurimi, atëherë i **porosituri** nuk mund të cilësohet si një person tjetër i lidhur për të justifikuar pasurinë mbi të cilën është zbatuar një kontratë porosie, në mungesë të indicieve të forta dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën, që hedhin dritë mbi posedimin dhe zotërimin e sendit nga subjekti i rivlerësimit...

9.4 ... shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit se ***** i tij ka pasur në mënyrë të vazhdueshme të ardhura nga toka bujqësore, pemëtaria, blegtoria, bletaria ku figuron i regjistruar dhe në regjistrin e fermerëve u dukën bindëse (faqe 17, paragrafi 3, fjalia e parafundit)

9.5 Trupi gjykues krijoi bindjen se *** i subjektit të rivlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta blerë këtë banesë dhe se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur atë mbështetur në një marrëdhënie familjare të shëndoshë që ata kanë.

10. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat që provojnë përdorimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit janë si vijon :

10.1. Të qënurit titullar i kontratës së furnizimit me energji elektrike, nga subjekti i rivlerësimit, për një send të paluajtshëm, është indicie për pronësinë mbi atë pasuri të paluajtshme.

⁵⁰ Referohu faqes 17 të vendimit të Komisionit

Duke qenë se shkresa e ZVRPP-së *****⁵¹, konfirmon si pronar shtetasin **, atëherë kjo kontratë dhe fakti i pranuar nga subjekti “*se e kam përdorur ndonjëherë me ditë gjatë pushimeve të verës*” ka të dhëna të mjaftueshme për të na çuar në konkluzionin e arritur më lart, se në këtë rast jemi para përdorimit të sendit sipas neneve 259, 260 dhe 251 të Kodit Civil.

10.2. Shpjegimet e subjektit se “*çelja e librezës së energjisë elektrike në emrin tim është bërëmeqë unë punoja në **** dhe *** banonte në *****” apo “*e kam përdorur ndonjëherë ..*” janë bërë me qëllimin e të mos kualifikuarit si “përdorim” të drejtën reale që kishte mbi banesën. Këto justifikime të krijojnë përshtypjen e shpjegimeve që jepen nga qytetarë të cilëve iu mungon formimi ligjor, por kurrsesi në nivelin më të lartë të kulturës ligjore dhe garantimit kushtetues të të drejtave, siç është rasti i subjektit të rivlerësimit.

10.3. Vlen për tu përmendur fakti, që pagesa e faturave të energjisë elektrike mund të bëhej nga subjekti i rivlerësimit edhe pa patur kontratën e furnizimit në emër të tij, pasi ka qenë dhe është e lejueshme që pagesat në sportel të realizohen nga persona që nuk janë titullar të kontratës së furnizimit me energji elektrike. Ajo ç’farë nuk ka qenë e lejueshme është lidhja e kontratës së furnizimit me një person, i cili nuk ka qenë **zotërues i sendit**, dhe kjo është ajo mbi të cilin Komisioni duhet të kishte hetuar më thellë.

10.4. Bazuar në vendimin nr.17 datë 19.12.2001 të Këshillit Drejtues të ERE-s “Mbi miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës, cilësohen si përdorues të energjisë elektrike personat fizikë dhe juridikë, **zotërues të objektit**, ku janë vendosur paisje që punojnë me energji elektrike dhe janë apo duan të lidhen në rrjetin elektrik.

10.5 Sa më sipër, vlerësojmë se fakti i përdorimit sipas nevojave të familjes dhe paisjes së librezës së energjisë elektrike për apartamentin me vendndodhje ***** në emër të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht mungesës të pronësisë së tij mbi këtë apartament, e kualifikon subjektin *si përdorues të sendit në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të drejtën reale si objekt deklarimi në Deklaratën Vetting*, dhe për rrjedhim kualifikon pronarin e këtij apartamenti si **person tjetër të lidhur**, duke i atribuar detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

11. Subjekti i rivlerësimit lidhur me pozicionin e ***** shpjegon se në referim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit 84/2016 ...*** nuk konsiderohet në këtë rast si person tjetër i lidhur pasi nuk ka cilësinë e huamarrësit, huadhënësit, dhuruesit të ndonjë pasurie që lidhet me subjektin e rivlerësimit në kuptim të dispozitave të KC që rregullojnë këto marrëdhënie juridike. Ky kuptim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron përse arsyetuar në pikën 10.5 më lart.

12. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat që dëshmojnë pamundësinë financiare të *** të blinte këtë pasuri janë si vijon :

12.1 Sipas dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit rezultojnë tre pasuri të paluajtshme në emër të ***** të subjektit të rivlerësimit, shtetasit **, konkretisht:

⁵¹ Referohu përgjigjes së kësaj zyre rajonale në dosje të Komisionit

- i. Tokë arë, me sipërfaqe 6.277 m², me vendndodhje në Zonën kadastrale ***, fshati ***, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. Akti *****⁵²;
- ii. Tokë arë, me sipërfaqe 2000 m², me vendndodhje në Zonën Kadastrale *****, fshati ***, në bashkëpronësi me të ***** shtetasin ***. Origjinë e kësaj prone është Kontrata e shitblerjes e datës * mars 2002, për çmimin 900 000 lekë (nëntëqind mijë) ⁵³;
- iii. Apartament, me sipërfaqe 60 m², me vendndodhje në zonën kadastrale *****, Fshati *****, *****. Origjina e kësaj prone është kontrata e shitblerjes e datës *** shtator 2003, për çmimin 1.900.000 lekë (një million e nëntë qind mijë)⁵⁴.

12.2 Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur ** janë :

a). dokumentacionin e ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore⁵⁵, totali i të ardhurave të ligjshme nga punësimi në sektorin shtetëror për periudhën 1994 – 2003, është në shumën **1.268.747** lekë;

b). Akt-ekspertimi për të ardhurat e personit tjetër të lidhur ** dhe familjes.

12.3 **Pas analizimit të mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur ** rezulton deri në vitin 2003 ka investuar në pasuri të paluajtshme sa më poshtë:**

*Tabelë nr.4
Pasuritë e të *** të subjektit **, deri në vitin 2003*

1	Apartament banimi në ** **	1.900.000 leke
2	Tokë arë *** 2000 m ² /50%	450.000 leke
	Gjithsej	2.350.000 lekë
	Të ardhura të ligjshme	1.268.747⁵⁶

Pra për sa më sipër, bazuar në të ardhurat e ligjshme **1 268 747** lekë personi tjetër i lidhur ** rezulton me të ardhura të ligjshme të pamjaftueshme për të justifikuar pasuritë e përshkruara më sipër.

Si përfundim, lidhur me pasurinë e mësipërme, konstatojmë se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe personi tjetër i lidhur nuk ka arritur të justifikojë bindshëm të ardhurat e ligjshme për investimin e bërë.

IV. Likuiditete

1. Sipas dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit u krye analiza e likuiditeteve, duke marrë në konsideratë:

- i. Të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe bashkëshortes të vërtetuara nga institucionet përkatëse për pagat neto ndër vite, pra pas kryerjes së pagesës për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe taksat;
- ii. Të ardhurat e krijuara si rezultat i shitjes së pasurive të luajtshme (makinës);

⁵² Shkresa nr.5091/1 prot, datë 15.01.2018 ZVRPP ***.

⁵³ Shkresa nr.313/ 1 prot, datë 12.1.2018 e ZVRPP ***. Kontrata është lidhur në Durrës para Noterit Publik *****, nr.499 rep, nr.127 Kol.

⁵⁴ Shkresa nr.100/1 prot, datë 16.01.2018 e ZVRPP ***. Kontrata është lidhur në Tiranë para Noterit Publik *****, nr.4041 rep., nr. 595 kol.

⁵⁵ Drejtoria Rajonale ***, me shkresën Nr. 131 prot, datë 16.02.2018

⁵⁶ Kjo është e ardhur nga pagat, dhe nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet jetësore të ***** të subjektit dhe familjes së tij, e cila është e përbërë prej katër vetë.

- iii. Të ardhurat e siguruara nëpërmjet kredive bankare,
- iv. Nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme, huaja prej 25 mije euro marrë **** dhe ****, pasi nuk vërtetohet me dokumentacion mbështetës ligjshmëria e burimit të krijimit;
- v. Likujditetet cash të deklaruara si kursime nga subjekti ndër vite;
- vi. Ndryshimi i vlerës së pasurisë, si rezultat i rivleresimit të apartamentit të blerë në vitin 1997 (Gjykata e Apelit Tirane);
- vii. Shpenzimet e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe sqarimeve të dhëna Komisionit në lidhje me shpenzimet për shkollim të fëmijëve, udhëtimet, mobilime etj;
- viii. Shpenzime jetësore bazuar në përlogaritjet e kryera nga ILDKPI;
- ix. Gjendjet në fund të vitit, në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes, bazuar në pasqyrat e lëvizjeve bankare të *****, ** dhe ****;
- x. Pasuritë e shtuara apo të pakësuara të vitit përkatës (apartament, automjet etj);

2. Nga kjo analizë kanë rezultuar vite në të cilat subjekti nuk mbulonte me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera, likujditetet e deklaruara dhe pasuritë e krijuara.

Tabele nr. 4

Analitike me vitet e pambuluara me të ardhura të ligjshme të shpenzimeve të kryera dhe pasurive të krijuara⁵⁷

	Analiza e sipas viteve	2010	2011	2012	2013	2014	2015
1	Gjendja ne banke fillim 01.01.	428,332	991,258	2,361,28 2	2,696,55 4	147,041	309,592
2	Ardhur/kredi/ shitje auto/rivleresim banese	0	0	0	16,800,0 00		
3	Te ardhura nga pagat (subjekti +bashkeshortja)	2,032,79 8	2,996,89 2	3,022,89 1	3,029,84 2	2,878,11 4	2,888,62 5
4	Shpenzime udhetime jash shtetit, shkollim, sponsorizim	158,570	344,283	172,816	160,000	1,146,61 6	812,510
5	Shpenzime jetese sipas ILDKPI	500,000	500,000	500,000	500,000	650,000	650,000
6	Shpenzime (paguar keste kredie/ apartamenti)	0	0	0	0	1,399,94 7	1,378,16 2
7	Likujditete (shtuar gjendje cash), pasuari	832,620	1,319,93 5	2,100,00 0	25,236,0 00	0	0
8	Gjendja ne banke 31.12	991,258	2,361,28 2	2,696,55 4	147,041	309,592	454,796

⁵⁷ Në aneksin bashkelidhur jepen te detajuara te ardhurat, shpenzimet, likujditete dhe mbulimi i tyre me te ardhura të ligjshme

			-		-		
					3,516,64	-	
Mbulimi i shpenzimeve me te ardhurat	-21,318	537,250	-85,197	5	481,000	-97,251	


Në vitin 2011, subjekti rezulton me një diferencë të pambuluar në shumën

537.250 lek. Në këtë vit subjekti ka deklaruar kursime apo gjendje cash 9500 euro ose e konvertuar 1,319,935 lek, gjithashtu gjendja në bankë në fund të vitit ka shkuar 2,361,282 leke (shtuar 1,370,023lek). Kursimet e shtuara në bankë dhe në banesë të subjektit për këtë vit të konvertuara në lekë janë 2,689,958 lek (9500 euro dhe 1,370,024 lekë).

Në vitin 2013, ka një diferencë të pambuluar prej 3,516,645 lekë. Në këtë vit subjekti ka blerë apartament + garazh me vlerë 25,236,947 lek. Për këtë apartament subjekti deklaron se ka marrë kredi pranë BKT në shumën 16,800,000 lek, ndërsa diferencën pretendon se e ka paguar me huanë e marë nga *** dhe ***, si dhe kursimet familjare. Por, nga analiza e mëparshme është konkluduar se i **** i subjektit dhe **** i subjektit nuk kanë të ardhura të ligjshme të mjaftueshme dhe të vërtetuara me dokumente ligjore për të mbuluar shumën e pretenduar si hua. Pra, në këtë vit diferenca e pambuluar përfaqëson huanë prej 25,000 euro mare borxh dhe e konsideruar si e ardhur jo e ligjshme e personave të lidhur me subjektin.

Në vitin 2014, rezulton një diferencë e pambuluar prej 481,000 lekë. Në këtë vit subjekti dhe bashkëshortja kanë gjendje në bankë shumën 454,796 lekë, kanë kryer pagesa për shkollim, mobilim, paguar këst kredie dhe shpenzime të nevojshme jetësore, të cilat nuk i mbulon me të ardhurat e ligjshme.

3. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten në mënyrë grafike pasuria⁵⁸ dhe të ardhurat neto⁵⁹ të subjektit të krijuara ndër vite.



Grafiku nr.1 Pasuria dhe të ardhurat neto të subjektit të krijuara ndër vite.

⁵⁸ Pasuria përfshin apartamentin 98 m2 të rivlerësuar, apartamentin dhe garazhin te kompleksi xxxxx dhe makinën.

⁵⁹ Të ardhurat neto përfshijnë të ardhurat e ligjshme të krijuara ndër vite nga pagat (subjeti dhe bashkeshortja), të ardhurat nga kredia marrë pranë xxxx, duke zbritur shpenzimet baze të jetesës për periudhën e analizuar.

V. Çështje të tjera

1. Komisioneri publik, thekson se sipas nenit E të Kushtetutës qëllimi i këtij rivlerësimi të aftësive profesionale është identifikimi i atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin dhe të atyre, të cilët kanë mangësi profesionale e që mund të korrigjohen përmes trajnimit profesional pa bërë ndarje apo kufizime në rrethin e subjekteve të rivlerësimit. Në këtë vlerësim përfshihet aftësia për të gjykuar, ajo organizative, etika, angazhimi profesional dhe cilësitë personale të subjektit.

2. Nga verifikimi i denoncimeve të ndodhura në dosjen e Komisionit, Njësia ligjore konstaton dhe denoncime të tjera drejtuar Komisionit të protokolluara nga ky i undit, për të cilat Komisioni nuk është shprehur në vendim dhe nuk kemi informacion nëse këto raste janë shqyrtuar apo jo.

3. Duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit të publikut në këtë proces⁶⁰, pritshmëritë dhe rolin e rëndësishëm të publikut në ndihmë të institucioneve rivlerësuese me anë të denoncimeve të fakteve dhe rrethanave të besueshme dhe me vlerë për procesin e rivlerësimit, referuar nenit 179/b të Kushtetutës (rikthimi i besimit të publikut), nenit 43/4⁶¹ dhe nenit 53 të ligjit nr.84/2016, vlerësojmë se Komisioni në çdo rast përveç parashtrimit të rrethanave të çështjes së denoncuesit, duhet të arsyetojë më tepër në lidhje me faktin e denoncuar dhe vlerën apo jo të tyre për procesin e rivlerësimit dhe aq më tepër të konsiderojë çdo denoncim të bërë nga publiku, pa i nënvlerësuar ato.

4. Nga përmbajtja e vendimit ashtu dhe nga dokumentacioni i paraqitur në dosje të Komisionit, nuk rezulton të kemi një relacion të detajuar, hartuar nga relatori i çështjes ashtu siç e parashikon neni 44 i ligjit 84/2016, në përfundim të të cilit relatori propozon për subjektin e rivlerësimit nëse është, “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”.Ky relacion, përbën një detyrim procedural ligjor, që nga Komisioni duhet të zbatohet në çdo rast, dhe jo rast pas rasti, në raport kjo jo vetëm me rëndësinë e këtij kriteri, por dhe në raport me qëndrimin e Komisionit ndaj rasteve të denoncimit nga publiku.

5. Komisioni, për më tepër ka bërë dhe një konstatim⁶², i cili është i paqartë, lidhur me subjektin e rivlerësimit, kur ka deklaruar se *z. Bashkim Dedja, për shkak të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit kushtetues, nuk përfshihet në programet e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, ndërsa është vetëtrajnuar pranë Shkollës së Magjistraturës.*

⁶⁰ Sipas nenit C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës

⁶¹ Nëse relatori vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera... mbi fakte të besueshme.. ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

⁶² Fq.21 e vendimit të Komisionit

6. Në mungesë dhe të administrimit të një informacioni të detajuar nga relatori i çështjes, për vlerësimin e aftësive profesionale, mbetet e paqartë nëse ky konstatim është bërë si rezultat i evidentimit të mangësive gjatë analizës së këtij kriteri, ashtu siç parashikon dhe neni 60 i ligjit 84/2016, apo është vlerësuar nga Komisioni se për shkak të detyrës funksionale të subjektit, nuk mund të jemi para aplikimit të një dispozite të tillë, nëse është kjo e fundit një kuptim i gabuar i rregullimeve ligjore në këtë drejtim.

7. Komisioni ka mbajtur një *qëndrim pa qëllim*, ose të paktën ky qëllim nuk është interpretuar ashtu siç duhet në përmbajtje të këtij vendimi. Lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, është shprehur vetë Gjykata Kushtetuese⁶³, e cila ka theksuar ndër të tjera se “...vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre, në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke krijuar një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

III. Kërkimi i ankimit

8. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit c/2, d, Ç dhe F/3 të Aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi nr.24 datë 13.06.2018 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin z. Bashkim Dedja, referuar akteve të administruara nga vetë Komisioni, nuk ka qenë i drejtë, konform Kushtetutës dhe ligjit, për të krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ka nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr.84/2016, si dhe rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit 84/2016 duke deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të plotë të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur, në kuptim të nenit D/1 të Kushtetutës.

9. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt.

⁶³ Paragrafi 17 i vendimit 28/2017

10. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë procesit, duke konstatuar qëndrime të padrejta dhe jo në përputhje me sa është administruar;

11. Referuar pikës 7 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës ku sanksionohet se “...7.Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim me shkrim të arsyetuar. Në rastet e ankimeve nga Komisioneri Publik, Kolegji nuk mund të vendosë një masë më të rëndë, pa i dhënë subjektit të rivlerësimit kohë të mjaftueshme për t’u përgatitur dhe për t’u dëgjuar në seancë.”

12. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe mbështetur në provat e mbledhura dhe sipas gjykimit në mbledhjen e fakteve ose provave të reja, në zbatim të gërmës “b” të nenit 66 dhe nenit 61 pika 3, të ligjit nr.84/2016 të vendosë:

1. Ndryshimin e vendimit nr.24, datë 13.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Bashkim Dedja.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA

